



Hetim Penal - si duhet vepruar ?

Çfarë duhet së paku të dini në këtë rast : Ky është një artikull i gatshëm për tu shkarkuar, shtypur dhe shpërndarë.

Një vjedhje në supermarket ? Delikte me lëndë narkotike ? Përdorim i dhunës fizike ? Dëmtim i pronës private ? Keni ndezur fishekzjarre në stadiumin e futbollit ? Keni thyer rendin dhe qetësinë shtëpiake ? Keni marrë pjesë në një protestë të paautorizuar ? Jeni kapur i dehur duke drejtuar makinën ?

Nëse srganet e drejtësisë ju kanë vënë në shënjestër, duhet ta dini se jeni duke qëndruar i vetmuar përballë një aparati shumë të organizuar shtetëror. Policia dhe gjykata kanë të drejtën që t'ju burgosin si të dyshuar. Mbase guxojnë të konfiskojnë edhe pasurinë tuaj, ju kanosen gjoba financiare deri në burgim, shpenzime të larta dhe shënime në regjistrin shtetëror për vepra penale. Kjo ka pasoja të rënda Sociale. Nëse nuk keni një pasaportë zvicerane, ju rrezikoni të dëboheni nga vendi.

Ky realitet nuk ka të bëjë gjë fare me një film të së Dielës në mbrëmje ku alibitë e gënjeshtërtat nuk funksionojnë gjithmonë. Drejtësia nuk fiton gjithmonë ndërsa rastet kur avokati juaj të pamundshmen e bën të mundshme, janë të rralla. Një hetim penal në shikim të parë duket më i thjeshtë se në film por ky fakt të gënjen. Si person i fajësuar në raste të tilla njohuritë tuaja janë të kufizuara dhe ndihma profesionale është më se e nevojshme.

Ky Artikull ju sqaron shkurt se ç' mund të ju ndodhë dhe çfarë ju kanoset në të vërtetë. Më shumë informacione mund të gjeni në librin tonë « Strafuntersuchung- was tun ? ». Një gjë është e qartë, ju duhet të njiheni me të drejtat tuaja për ti kuptuar ato si të tilla.

Pse ju ndihmon fakti nëse thoni: Unë nuk dua të deklarohe.

Nëse organet policore ngjallin dyshim te ju ata vazhdojnë hetimet ndaj jush dhe juve ju kanoset një çështje penale në vazhdim. Qoftë edhe një person privat apo zyrtar, çdonjëri

mund të paraqesë një padi kundër jush. Si zakonisht në këso raste ju thirreni në polici dhe mund të burgoseni. Papritmas ju qëndroni para Hetimeve.

Qëllimi kryesor i hetimeve bazohet në zbulimin e pafajësisë suaj. Për sa kohë ndaj jush nuk mund të vërtetohet vepër penale ju jeni të pafajshëm.

Njoftim i vlefshëm për ju. Ju keni shumë të drejta. Në qendër të problemit është e drejta e juaj që mos ta pranoni të jepni dëshmi dhe të mos pranoni veprën. Organet e drejtësisë në këtë rast e kanë shumë të vështirë të ju fajësojnë pa dhënë ju dëshminë.

Kjo do të thotë, nëse ju nuk pranoni të jepni dëshmi nënkuptohet se ju nuk pranoni fajësinë. Ju nuk thoni «as Po as Jo» por vetëm përsërisni në mënyrë të vazhdueshme fjalët «Unë nuk dua të jap dëshmi». Fjalët si «Po ose Jo» ose «Nuk di më tepër» mund të jenë shumë negative për ju gjatë një procesi të mundshëm pasi çdo fjalë e juaj ka peshë.

Asnjëherë nuk duhet nënçmuar akti i mosdhënies së dëshmisë për ndonjë vepër penale. Për këtë hap ju duhet shumë fuqi dhe kurajë pasi organet të cilat ju marrin në pyetje kanë metoda të sofistikuara jo të dhunshme për t'ju detyruar që ju ta ndryshoni deklaratën e juaj.

Nëse ju gënjeni, kjo nuk ka shumë pasoja negative për ju. Me rëndësi është që ju mos të akuzoni një njeri të pafajshëm për ndonjë vepër të cilën ai nuk e ka kryer fare. Mos harroni fjalën e urtë «Gënjeshtër i ka këmbët e shkurtra». Në shumicën e rasteve gënjeshtër zbulohen.

Deklarata e juaj është një dëshmi dhe drejtësia mbështetet tek ajo në imtësi. Ju në fillim nuk keni njohuri për dëshmitë të cilat i posedon prokuroria kundër jush si p.sh. (rreth gjurmëve të ADN, regjistrimet me video-kamera, thirrjet telefonike). Rreziku i një Deklarate jo të saktë është tepër i madh pasi ju nuk jeni në dijeni të dëshmive të cilat i posedon prokuroria. Një kala me gënjeshtër nuk mbrohet për një kohë të gjatë. Një gjë e tillë është gati sa e pamundur. Hetuesit kanë shumë përvojë dhe nuk janë naivë.

Asnjëherë nuk është e gabuar nëse ju nuk thoni asgjë pa prezencën e avokatit apo avokates suaj.

Nëse keni marrë një thirrje nga prokuroria gjëja e parë që duhet bërë është të konsultoheni me avokatin ose avokaten tuaj për hapat e mëtejshëm nëse ju duhet mbrojtje apo jo. Nëse burgoseni ju nuk duhet të jepni asnjë deklaratë dhe kërkoni menjëherë një

avokat. Mundësisht një avokat tek i cili keni besim reciprok. Si fillim ju duhet të keni një mbrojtje dhe kjo gjë është shumë e rëndësishme për hapat e parë.

Mos harroni: Ju keni të drejtë që të mos e jepni deklaratën. Ju keni të drejtë që nga fillimi i hetimeve për mbrojtje nga ana e avokatit tuaj brenda kornizave ligjore. Në qendër të ngjarjes jeni vetëm ju dhe ajo çka është e rëndësishme për ju. Organi i mbrojtjes është instancë e pavarur por njëkohësisht në shërbimin tuaj. Avokati juaj iu nënshtrohet rregullave për ruajtjen e të dhënave prandaj besueshmëria ndaj tij duhet të jetë e pakushtëzuar.

Një këshillim prej gjysmë ore për të drejtat e juaja me një avokat apo avokate në kolektivin e avokatëve të Zyrihut (www.anwaltskollektiv.ch) kushton 60.- Në faqen e uebit (www.strafuntersuchung.ch) mund të gjeni listën e të gjithë avokatëve dhe avokateve të këtij kolektivi të cilët ju ofrojnë shërbime të nevojshme.

Pothuajse në të gjitha kantonet ka një qendër lokale për mbrojtje penale në raste shumë të shpejta. Këto mund ti gjeni në shtojcën e librit tonë « Strafuntersuchung – was tun ? » ose në internet. Aty gjeni edhe adresat e avokatëve dhe avokateve të cilët ofrojnë shërbime si mbrojtës ligjorë dhe me të cilët mund të kontaktoni në çdo kohë.

Shpenzimet e këtyre konsultimeve duhet ti bisedoni direkt në mënyrë individuale me personin e caktuar.

Njoftim i vlefshëm për ju. Në raste të veçanta kur jeni për një kohë të gjatë në paraburgim një avokat mbrojtës është domosdoshmëri e detyrueshme për ju. Kjo ndodh më shumë në rastet kur juve ju kanoset një qëndrim i gjatë në paraburgim apo një dënim i ndjeshëm ose duhet të stacionoheni për një kohë të gjatë për t'ju nënshtuar një terapie në një institut të mbyllur e në rastin më të keq edhe kur ju kanoset dëbimi nga shteti. Avokati ju duhet po ashtu edhe në ato raste kur ju nuk jeni në gjendje të mbron vetveten.

Nëse ju nuk jeni në gjendje që ti mbulonit shpenzimet për avokatin tuaj atëherë këto raste trajtohen ndryshe dhe shpenzimet i merr përsipër vet shteti pasi e drejta për mbrojtje është e detyrueshme.

Edhe në shumë raste të tjera ekzistojnë mundësitë e ndryshme se si ju të keni avokatin tuaj pa u menduar shumë se kush do ti marr përsipër shpenzimet. Një kërkesë e tillë për lehtësimin e shpenzimeve mund ta bëni tek avokati juaj. Kërkesa e juaj duhet të merret në konsideratë dhe përzgjedhjen e palës Mbrojtëse keni mundësi ta bëni sipas dëshirës suaj.

Kush janë Kundërshtarët tuaj : Policia dhe prokurori shtetëror.

Që në hapat e parë të hetimeve keni të bëni me policinë dhe prokurorinë. Qëllimi i tyre është që të nxjerrin në dritë drejtësinë. Ata marrin parasysh materialet që ju fajësojnë juve apo e kundërta. Si zakonisht ata kërkojnë fakte për ta vërtetuar pafajësinë tuaj mirëpo në

plan të parë ata mbështeten në dyshimin se diçka ka ndodhur. Kjo do të thotë se ata mundohen të zbulojnë fakte me të cilat do ju ngarkojnë juve me faj.

Prandaj mbrojtja e juaj ka një rëndësi të veçantë në këto momente pasi ky organ bën korrigjimet e gabimeve të mundshme gjatë hetimit, ju mbështet në çdo hap dhe ndërmjetëson mes jush dhe organeve të drejtësisë. Nëse ndodh që ju në momentin e hetimit nuk keni avokat mbrojtës, ju duhet patjetër të shënoni emrin e personit i cili ju merr në pyetje dhe më në fund të kërkonti një procesverbal të nënshkruar.

Si është rrjedha e procesit gjyqësor.

Me hapjen e procesit fillojnë kërkimet nga ana e policisë dhe prokurorisë. Nëse jeni i burgosur, pas katër ditëve gjykatësi i burgimit vendos kohëzgjatjen e paraburgimit dhe verifikon nëse ky paraburgim ka apo nuk ka mbështetje të mjaftueshme ligjore. Është mirë që të luftoni për një paraqitje para gjykatësit i cili është kompetent për këtë vendim, në rast se këtë pyetje ua parashtron prokuroria. Gjatë paraburgimit ju keni të drejtë të bëni kërkesë për lirim, këtë mund ta bisedoni me avokatin apo avokaten tuaj në rast se kjo gjë është e nevojshme.

Kërkimi mund të mbyllet nga ana e prokurorisë vetëm në këto raste:

- Mbyllja e procesit hetimor mund të ndodhë në mungesë të fakteve për një vepër penale ose nëse nuk ekziston një kallëzim konkret për një gjë të tillë. Një mbyllje e lëndës mund të ndodhë edhe në rastet kur ju me personin i cili ka deponuar padi ndaj jush keni bërë një marrëveshje paraprake
- Kur akuza tërhiqet me vendimin e gjykatës
- Me një urdhëresë të prokurorisë, nëse paraprakisht faji pranohet ose hetimet kanë qenë të mjaftueshme dhe vepra është konfirmuar, dënimi është nën gjashtë muaj burgim ose gjobë në të holla, vlera e së cilës qëndron po aq e lartë sa masa e dënimit të shpalluar. Këto lloje shpallje të dënimeve janë mënyra të lehtësuara, të cilat vlejnë vetëm për raste të veçanta. Kundër një vendimi të tillë ju keni të drejtë apelimi pra kundërshtimi në një afat kohor brenda dhjetë ditëve. Pas kësaj prokuroria do të ri-kontrollojë të dhënat. Nëse në momentin e shpalljes së këtij vendimi nuk jeni të pranishëm mundet që kërkesa juaj të shpallet e pavlefshme.
-

Ku duhet ju jashtëzakonisht të keni kujdes: Provat dhe dinjiteti juaj.

Provat më të rëndësishme që keni për mbrojtjen tuaj në shumicën e rasteve mund të jenë njëkohësisht edhe dëshmi për fajësinë tuaj ashtu si edhe deklaratat e dëshmitarëve, informantëve dhe personave të besueshëm. Prandaj pas përfundimit të marrjes në pyetje nga organet kompetente duhet të kërkonti një procesverbal dhe ta lexoni me vëmendje. Mundohuni të jeni i saktë dhe jo i luhatshëm. Mos ndryshoni kuptimin e deklaratave tuaja pra mundohuni të thoni përherë fjalët e njëjta dhe versionin e njëjtë. Deklarata të tjera bindëse: gjurmët e DNA-së, vlerësimet kompjuterike/telefonike, regjistrimet video, kërkimet në shtëpi, informacionet nga banka juaj. Mendimi i ekspertit: Nuk jeni të detyruar t'i jepni policisë, prokurorit ose gjykatës, fjalëkalimet e llogarive tuaja ose të kompjuterit/celularit.

Falë provave teknike dhe metodave të përsosura të cilat e zbehin dinjitetin tuaj, prokuroria dhe gjykatësit janë në gjendje të zbulojnë gënjeshttrat. Prandaj ju keni të drejtë të heshtni dhe të mos thoni asgjë pasi edhe gënjeshttra më e vogël mund ta tronditë besueshmërinë tuaj. Një fjalë e urtë thotë “Atij që gënjen njëherë nuk mund ti besohet edhe nëse ai e tregon të vërtetën”.

Proceset gjyqësorë nuk përfundojnë gjithmonë me një rezultat të këndshëm.

Në fund të procesit gjyqësor shpallet vendimi nga ana e gjykatësit dhe ju mund të shpallen fajtor ose i pafajshëm. Sidoqoftë jepet një vendim i prerë. Ka raste kur merren vendime të përshpejtuara nga ana e gjykatës me të cilat mbyllet procesi me të ashtuquajturën “Marrëveshje me prokurorinë”. Në raste të tilla bashkë me ju duhet të jetë prezent edhe avokati juaj cili ju përfaqëson në këtë çështje. Një konsultim paraprak është tepër i këshillueshëm dhe i rëndësishëm.

Mbyllet procesi gjyqësor dhe shpallet një vendim, ju si person i shpallur fajtor ose gjykata por edhe pala e dëmtuar, kanë mundësi që lëndën ta paraqesin në nivele më të larta si p.sh. në gjykatën kantonale ose gjykatën e lartë.

Pas kësaj instance të gjitha palët e përfshira ekanë rrugën e hapur për gjykatën supreme e cila nuk e verifikon lëndën plotësisht por përqendrohet në pyetjet e veçanta të së drejtës bazuar nga proceset e kaluara.

Përse bëhet fjalë? Çfarë ju kanoset? Dënimet dhe Masat

Si dënime vihen në zbatim heqja e lirisë (Burgimi), dënim me të holla, ose gjoba. Disa nga këto dënime (përveç gjobës) mund të jenë “të kushtëzuara”, pra me një periudhë

prove. Kjo do të thotë që nëse nuk kryeni më shkelje të dënueshme brenda një periudhe prove (nga dy deri në pesë vjet), nuk keni më nevojë të vuani dënimin. Gjobat e vogla (të transportit) gjatë periudhës së provës nuk ju ngarkohen. Megjithatë, dënimet mbi tre vjet duhet gjithmonë të kryhen, ato për më shumë se dy vjet të paktën pjesërisht.

Lartësia e dënimit me të holla matet nga masa e fajit dhe nga sasia e të ardhurave dhe pasurisë suaj. Ky lloj dënimi aplikohet vetëm atëherë kur masa e dënimit është më e ulët se një gjysmë viti burg. Puna e bamirësisë është një opsion nëse dënimi nuk është më shumë se gjashtë muaj burgim. Në rastin e dënimeve më të shkurtra me burgim, ekzistojnë gjithashtu, në disa kushte të caktuara, mundësitë e punës së bamirësisë, mbikëqyrjes elektronike ose gjysmë-paraburgimit.

Krahas dënimit gjyqi mund të ndërmarrë masa si dëbim nga shteti apo një terapi mjekësore ose një ndalim nën kujdestari. Kjo nënkupton heqje lirie e qëndrueshme për një kohë të pacaktuar. Kjo metodë aplikohet vetëm në raste të krimeve shumë të rënda dhe nën masa të rrepta kontrolli. Edhe trajtimet me terapi, të ashtuquajturat masat stacionare për shërimin e varësisë ose çrregullimeve mendore apo psikike, kufizojnë dukshëm lirinë e tuaj dhe zgjasin shumë kohë.

Krahas këtyre masave mjekësore me terapitë e përmendura ekzistojnë edhe metodat mjekësore nëpër ambulancat e ndryshme, kjo vlen për rastet kur masa e dënimit është shumë e lehtë dhe ju e vuani dënimin në shtëpi.

Për të miturit ekzistojnë masa speciale ku në mënyrë të kontrolluar mësohen të marrin përsipër përgjegjësitë e veta dhe të jetojnë një jetë pa kundërvajtje.

Përveç kësaj ka edhe mënyra tjera ku atyre u ndalohet të ngasin makinën ose të ushtrojnë një profesion të zakonshëm. Tek të huajt këto masa janë edhe më të rrepta pasi atyre ju kanoset edhe riatdhesimi apo dëbim me forcë në shtetin përkatës.

Për krimet apo kundërvajtjet ligjore, të cilat do të kryhen pas 1. Tetorit 2016, në shumicën e rasteve, gjykata penale do të urdhërojë dëbimin tuaj nga shteti. Për deliktet e kryera para kësaj date vendos zyra për emigracionin. Kjo zyrë vendos nëse ju do të dëboheni ose jo nga shteti, pasi të shpallet dënimi. Ne i këshillojmë emigrantët dhe emigrantet që në rast se u kanoset dëbimi nga shteti mundësisht të marrin kontakt shpejt me një avokat, i cili ka njohuri të nevojshme mbi të drejtat e shtetasve të huaj dhe të bisedojnë me të.

Gjëja më e rëndësishme për ju është të njihni të drejtat tuaja.

Drejtësia ka një arsenal të fortë në dorë në luftën kundër jush nëse vendos të ndërmarrë masa ndaj jush. Sa më mirë të njihni mundësitë dhe hilet e kundërshtarit tuaj aq më mirë mund të përgatiteni për tu mbrojtur. Prandaj për ju vlen të merrni këshillat e duhura dhe të

merrni kohë të mjaftueshme për tu informuar. Këshillohuni me kohë sepse kjo do ju duhet. Ja vlen gjithsesi!

Është me rëndësi! Ky artikull mund t'ju udhëheqë vetëm për gjërat më të rëndësishme kurse këshilla të hollësishme mund të gjeni në librin tonë "Strafuntersuchung-was tun?", të cilin mund ta gjeni në faqen tonë të uebit ([www. Strafuntersuchung.ch](http://www.Strafuntersuchung.ch)), te kolektivit të avokatëve të Zyrihut (www.anwaltskollektiv.ch) ose mund ta porosisni në çdo librari dhe kushton përafërsisht CHF 25.-

Ky libër me volum prej plot 200 faqesh sqaron në detaje në mënyrë praktike ecurinë e një hetimi penal. Ne ju sqarojmë se si funksionon policia, si vepron gjykata dhe ku janë kufijtë e veprimit të autoriteteve, po ashtu ju tregojmë se si merren dhe trajtohen dëshmitë dhe si merren vendimet për shpalljen e dënimeve.

E rëndësishme është që ju dhe pala mbrojtëse të keni njohuri të mjaftueshme mbi të drejtat e tuaja. Nëse keni nevojë për këshilla personale ju rekomandojmë një intervistë këshillimi 30-minutëshe, e cila juve ju kushton CHF 70.- në zyrat tona për këshilla juridike nga kolektivi i avokatëve në adresën Kernstrasse 8/10, 8004 Zyrih. Tel. 044 241 23 33, pa lajmërim paraprak. Ju mund të vini çdo pasdite ndërmjet orës 12.30 deri 18.30. Si zakonisht këshillat jepen në Gjermanisht, por shumë nga avokatet dhe avokatët tanë mund t'ju këshillojnë edhe në Anglisht, Frëngjisht, disa edhe në Italisht dhe Spanjisht. Nëse ju flisni një gjuhë tjetër, mund të merrni natyrisht një përkthyes.

Në faqen e poshtëshënuar të uebit (www.strafuntersuchung.ch) mund të gjeni një listë me emrat e avokatëve dhe avokateve të kolektivit të avokatëve për këshilla juridike. Gati në të gjitha kantonet ekzistojnë avokatë mbrojtës për hetime penale për raste urgjente. Adresat e tyre janë të shënuara në aneksin e librit tonë « Strafuntersuchung- was tun ? » ose në internet. Këta avokatë mund ti kontaktoni çdo kohë direkt për nevojat e juaja në raste urgjente.